



## **PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

### **Nr. 30**

Datë: 10. 11. 2022. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Valmira Semnai, drejtoreshë u.d., e ZRPPC.

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

### **RENDI I DITËS**

**1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**

**2. Aktivitetet e SKQZ-së**

**-Njoftim lidhur me dorëheqjet e Zyrtarëve të Lartë Komunal të Zgjedhjeve të Komunave Mitrovica e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok**

**3. Raport i Këshillave të KQZ-së:**

- **Këshilli për Çështje Ligjore**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për zyrën e presidentes, për zëvendësimin e deputetëve të subjektit politik "Lista SRPSKA"

2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësim të anëtarëve të Kuvendit Komunal në Ferizaj, Malishevë dhe Junik.

#### **4. Të ndryshme**

---

##### **1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**

**Kreshnik Radoniqi:** E hapi mbledhjen e 30-të, para vetit e keni rendin e ditës...

Pasi që kryetari Radoniqi paraqiti agjendën e mbledhjes, anëtarët e KQZ-së miratuan rendin e ditës.

##### **1. Aktivitetet e SKQZ-së**

Njoftim lidhur me dorëheqjet e Zyrtarëve të Lartë Komunal të Zgjedhjeve të Komunave Mitrovica e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok:

Në vazhdim të takimit, Burim Ahmetaj paraqiti raportin e rregullt të aktiviteteve të Sekretariatit të KQZ-së me ç'rast, ai tha se me planin e punës, Sekretariati është duke vazhduar me hartimin e strategjisë 2023-2026. Lidhur me këtë, nën Grupi Punues për hartimin e strategjisë së KQZ-së 2023-2026, i përbërë nga Sekretariati, me datë 8 nëntor ka raportuar tek koordinorët e grupit punues që përbehet nga anëtarët e KQZ-së. Në takim, nëngrupi punues prezantoi veprimet e hapave të ardhshëm. Në këtë fazë, KQZ ka zhvilluar vetëm një draft koncept të bazave strategjike: misioni, vizioni, parimet orientuese; dhe ka identifikuar shtyllat dhe synimet kryesore strategjike.

Lidhur me këtë KQZ dëshiron që të konsultohet me akterët e jashtëm në mënyrë që të definohen këto elemente, para se të vazhdojmë me hapat e radhës në këtë proces. Koordinatorët e grupit punues miratuan në parim listën e propozuar të akterëve të jashtëm. Akterëve të jashtëm, i'u është dhënë afat deri me 20 nëntor për komente.

Në vazhdim, Ahmetaj tha se Sekretariati nga Presidenca ka pranuar kërkesën për zëvendësimin e Deputetëve të Kuvendit të Kosovës të cilët kanë dhënë dorëheqje nga Lista Serbe. Me datën 7 nëntor 2022, përmes zyrtarëve të Lartë Komunal të Zgjedhjeve nga Komunitet Mitrovicë e Veriut, Zveçan,

Leposaviq dhe Zubin Potok kemi pranuar dorëheqjet e Kryesuesit dhe Asamblistëve si dhe Kandidatëve në listën në pritje nga Lista Serbe të Komunave Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok. Me datë 9 nëntor 2022, kemi pranuar edhe dorëheqjet e ZLKZ-ve nga procesi i organizimit të mundshëm të zgjedhjeve të jashtëzakonshme. Bazuar në nenin 68 paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, të gjitha KKZ-të i administrojnë zgjedhjet përbrenda komunës, nën mbikëqyrjen ekskluzive dhe udhëzimet e KQZ-së që vepron përmes Sekretariatit, duke garantuar ligjshmëri, legjitimitet dhe efikasitet të procesit zgjedhor.

Kryeshefi Ahmetaj, në fund të raportit të tij tha se, duke pasur parasysh rrethanat e krijuara, Sekretariati i KQZ-së ka draftuar buxhetin si dhe Planin Operacional për zgjedhjet e jashtëzakonshme në Komunitet Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok.

**Sami Kurteshi**, tha se janë dy çështje: një, fatkeqësisht zyrtarët komunal kanë dhënë dorëheqje por ata, janë pjesë e administratës dhe ata nuk i përkasin një partie politike, e dyta, mendoj se dorëheqja e tyre nuk duhet të pranohet sepse edhe deputetët por edhe anëtarët e asamblesë kanë dhënë dorëheqje individuale, e treta, këta kanë dhënë dorëheqje nga një pozicion që se kanë: këta, nuk janë kryetar – janë zyrtarë, pra ata nuk mund të japin dorëheqje...! Këta janë kryesues, nuk kanë areysetime si “diskriminim”, “mosbashkëpunim” etj., dhe dorëheqja e tyre nuk është e drejtë...

**Ilir Gashi**: Meqë, janë pjesë e Sekretariatit, pyes cila është përgjigja, veprimi për këto pozicione. Ne, jemi në një realitet të ri...! Ndoshta, edhe kryetari mund të na informojë nga takimi në Presidencë...!

**Burim Ahmetaj**, tha se Sekretariati

## **2. Raport i Këshillave të KQZ-së:**

### **Këshilli për Çështje Ligjore**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për zyrën e presidentes, për zëvendësimin e deputetëve të subjektit politik “Lista SRPSKA”:

*( Nuk ka incizim, lidhur me këtë pikë...)*

2.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësim të anëtarëve të Kuvendit Komunal në Ferizaj, Malishevë dhe Junik”:

**Sami Hamiti**, tha se këshilli ka shqytuar zëvendësimet, kërkesat e ardhura dhe se, dokumentacioni ka qenë në rregull. Kështu, Mursel Salihaj emërohet asambleistë në komunën e Junikut nga subjekti politik LDK, duke e zëvendësuar anëtarin e deritashme Albertina Gacaferri.

Me 11 vota për, miratohet ky zëvendësim.

**Sami Hamiti**: Verona Isaku, emërohet asambleistë në komunën e Ferizajt nga subjekti politik LDK, duke e zëvendësuar anëtarin e deritashme Sibel Halimin.

Me 11 vota për, miratohet ky zëvendësim.

**Sami Hamiti**: Bashkim Berisha emërohet asambleistë në komunën e Malisheves nga subjekti politik Nisma socialdemokrate, duke e zëvendësuar anëtarin e deritashëm Jahir Xhuliqin.

Me 11 vota për, miratohet ky zëvendësim.

**Sami Hamiti**: Si njoftim, ju tash e dini se anëtarët e kuvendeve komunale të katër komunave në veri, kanë dhënë dorëheqje ! Këta, janë pjesë e subjektit “Lista Serbska”. Ne e kemi analizue në këshill, por edhe anëtarët e tjerë në pritje eventualisht, kanë deklaruar se nuk e pranojnë mandatin. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, duhet ta trajtojë këtë çështje, dhe ne ju kemi drejtuar si këshill...! Jemi në situatë kur, këto kuvende edhe po të plotësoheshin nuk e mbërrijnë kuotën...

**Sami Kurteshi**: Ne, i kemi dorëheqjet por kuvendet nuk janë shpërnda. Kemi situatë të ndryshme, në komunat e ndryshme! Është kërkuar sqarim nga MPLA...

**Alim Rama**: Unë mendoj se, rasti duhet të trajtohet komunë për komunë! Ka komunë si Zubin Potoku ka kandidatë që i plotësojnë kushtet dhe janë në pritje, po ashtu, edhe Mitrovica e veriut, ku kemi mjaftueshmëri dhe kuvendi është funksional...

**Sami Hamiti**: Ne, nuk kemi kushtet ligjore sepse, kush do ti procedojë kërkesat për zëvendësim...? Nuk kemi kriter ligjorë, nuk është plotësuar...MPLA ka afat 7 ditë të na përgjigjet...

**Illir Gashi**, tha se e kemi trajtuar por s'kemi përgjigje sepse, është rruga që ndiqet – rruga ligjore dhe kjo është e shkatërruar sepse, s'ka kush... Kemi kërkuar nga Sekretariati që ta shoh gjendjen komunë për komunë...

**Të ndryshme !**

**Kreshnik Radoniqi**: Unë jam takuar me Presidenten por ka qenë një takim konsultativ dhe, në rast eventual nëse kemi zgjedhje – të shohim...Asgjë s'kemi biseduar për këto që u thanë...